

## DIREKTIVA E MBROJTJES 2018

### I. HYRJE

Viti 2017 shënoi arritje të suksesshme në të gjitha fushat e veprimtarisë dhe angazhimit të strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Vijimi i procesit të reformimit dhe transformimit të tyre ka rezultuar në përmbushjen me sukses të misionit kushtetues, detyrimeve ligjore për sigurinë dhe mbrojtjen, si dhe angazhimet në kuadër të Aleancës.

Hapa të rëndësishëm janë arritur në përmirësimin e legjislacionit, ku mund të përmendim miratimin e Strategjisë së Mbrojtjes Kibernetike, hartimin e Strategjisë Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë, si dhe fillimin e procesit të përgatitjes së Dokumentit të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes, si një proces i përhershëm transformimi, i orientuar nga dokumentet strategjike kombëtare dhe ato të NATO-s.

Procesi i modernizimit të Forcave të Armatosura ka arritur rezultate të prekshme. Kompletimi me paketën e parë dhe të dytë të mjeteve të blinduara HMM/WV të Grup-Batalionit të Këmbësorë së Lehtë, pajisja me mjete të blinduara e Policisë Ushtarake, blerja e armatim-municionit 60 mm dhe 81 mm për strukturat e Forcës Tokësore, sigurimi i shërbim-mirëmbajtjes për helikopterët e Forcës Ajrore kanë përmirësuar ndjeshëm operacionalitetin, lëvizshmërinë, ndërveprueshmërinë e strukturave të Forcave të Armatosura. Arritjet në fushën e modernizimit kanë qenë fryt i realizimit me efektivitet të buxhetit, rritjes së transparencës dhe luftës kundër korrupsionit, rishpërndarjes së fondeve, duke bërë të mundur maksimizimin e performancës, në përputhje me prioritetet e Ministrisë së Mbrojtjes.

Gjatë vitit 2017 është realizuar me sukses kontributi ndaj tri detyrave kryesore të Aleancës, atë të Mbrojtjes Kolektive, Menaxhimit të Krizave dhe Bashkëpunimi për Siguri. Janë përmbushur angazhimet me kontribute në Strukturën e Komandimit të Forcës së NATO-s, Planin e Masave për Gatishmërinë dhe në Forcën e Përparuar të NATO-s. Kontributi në operacionet e NATO-s ka vijuar trendin e rritjes me dyfishimin e angazhimit në Kosovë, materializimin e angazhimit në Prezencën e Përparuar të NATO-s në Letoni, përmbushjen e angazhimeve në Afganistan dhe detin e Egje, si dhe pjesëmarrjen në misionet e Bashkimit Evropian në Mali dhe Bosnjë-Hercegovinë. Kontributi i Forcave të Armatosura brenda vendit ka arritur rezultate të larta, ku gjatë vitit 2017 është trefishuar numri i operacioneve në krahasim me vitin 2016.

Mjedisi i sotëm i sigurisë është i paparashikueshëm, sfidat ndaj tij kërkojnë përjasje gjithëpërfshirëse, bashkëpunim dhe kontribute të përbashkëta, si parakushte të një suksesi të mëtejshëm. Direktiva e Mbrojtjes 2018 mbështetet dhe garanton përmbushjen me sukses të detyrimeve ndaj dokumenteve strategjike kombëtare, dokumenteve themelore të NATO-s dhe Bashkimit Evropian.

### II. PRIORITETET KRYESORE PËR VITIN 2018

Nisur nga kërcënimet dhe rreziqet aktuale dhe të pritshme të mjedisit të sigurisë, misioni kushtetues, detyrimet ligjore dhe ato ndaj Aleancës, **prioritetet kryesore të Forcave të Armatosura për vitin 2018 të jenë:**

1. Rritja e kapaciteteve ushtarake dhe cilësisë së profesionalizmit të Forcave të Armatosura;
2. Rritja e kontributit të Forcave të Armatosura në shoqëri dhe në vend.

**Objektivat kryesore strategjike për përmbushjen e këtyre prioriteteve të jenë:**

- Rritja graduale e kapaciteteve ushtarake të FA-së, bazuar në standardet dhe parimet e Aleancës së Atlantikut të Veriut dhe vijimi i angazhimit tonë operacional maksimal në misionet e mbrojtjes kolektive dhe ato paqeruajtëse të drejtuara nga Aleanca;
- Përmirësimi i transparencës së procedurave për rekrutimet dhe karrierën në Forcat e Armatosura;
- Përmirësimi i cilësisë së edukimit dhe trajnimeve për Forcat e Armatosura, duke e transformuar atë në një instrument formimi profesional për të rinjtë në kuadrin e misionit të posaçëm “Rini – Talent – Mundësi – Dinjitet”;
- Reformimi i kuadrin ligjor, përgjegjësi dhe organizimit brenda fushës së reagimit të emergjencave civile, me qëllim zvogëlimin e kohës së reagimit dhe rritjen e efektivitetit të përgjigjes ndaj tyre, si dhe krijimi i kapaciteteve të komponentit rezervist i orientuar në përgjigje ndaj emergjencave civile;
- Rritja e përfshirjes së Forcave të Armatosura në veprimet parandaluese në lidhje me emergjencat civile, nëpërmjet përgatitjes së studimeve për rreziqet, përforcimet e argjaturave të lumenjve, me qëllim zvogëlimin e kostove të shpenzimeve për buxhetin dhe ekonominë;
- Rritja e kontributit të Forcave të Armatosura në përmirësimin e infrastrukturës në zonat e largëta si iniciativat vullnetare.

### **III. DREJTIMET KRYESORE TË PUNËS PËR VITIN 2018**

Me qëllim realizimin e prioriteteve dhe objektivave strategjike, puna e strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, për vitin 2018 të përqendrohet në këto drejtime kryesore:

#### **1. Reformimi dhe transformimi**

- Reformimi dhe transformimi i Forcave të Armatosura të synojë realizimin e objektivave të qeverisë, arritjen e standardeve ndaj kërkesave të Aleancës, përmbushjen me profesionalizëm të angazhimeve në nivelin kombëtar, detyrimeve në kuadrin të NATO-s dhe pjesëmarrjes në nismat e ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare;
- Të punohet për të krijuar një forcë ushtarake efektive profesionale, të stërvitur e mirëpajisur, të gatshme, të dislokueshme, të mbështetur dhe të ndërveprueshme, bazuar në standardet dhe parimet e Aleancës, për të mbështetur misionin kushtetues dhe vijuar angazhimin tonë operacional maksimal në misionet e mbrojtjes kolektive dhe ato paqeruajtëse të drejtuara nga Aleanca dhe organizmat e tjera ndërkombëtarë.

#### **2. Planifikimi i Mbrojtjes**

- Planifikimi i Mbrojtjes të bazohet në dokumentet strategjike, si: Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia Ushtarake, Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2016-2025, të jetë në harmoni me planifikimin e Aleancës, si dhe të

reflektojnë procesin dinamik të transformimit të NATO-s, duke ndjekur ndryshimet e vazhdueshme të mjedisit të sigurisë;

- Fokusi i procesit të Planifikimit të Mbrojtjes gjatë vitit 2018 të jetë zhvillimi dhe zbatimi i Objektivave të Kapaciteteve në përputhje me Procesin e Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s, Planin e Masave të Gatishmërisë së Aleancës, vendimet e Samitit të Ullesit dhe Varshavës. Prioritet parësor të jetë përgatitja dhe vendosja në dispozicion të NATO-s (2019), e Grup-Batalionit të Këmbësorisë të Lehtë;
- Hartimi i programeve të mbrojtjes dhe përditësimi i listës së prioriteteve të ketë si objektiv, grup-batalionin dhe elementët e tij mbështetës, sistemet e komunikimit kombëtar statik dhe të dislokueshëm, krijimin e Njësisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike (2019), kërkesat operacionale për transportin strategjik të shumëllojshëm për dislokimin e trupave në kuadër të angazhimeve të Task-Forcës së Përbashkët të Gatishmërisë Shumë të Lartë dhe Forcës së Reagimit të Shpejtë të Aleancës. Drejtuesit e programeve dhe komandantët e forcave kryesore të angazhohen personalisht dhe të kenë një rol parësor në hartimin e programeve të mbrojtjes dhe përditësimin e listës së integruar të prioriteteve.

### 3. Zhvillimi i kapaciteteve dhe modernizimi

- Modernizimi i Forcave të Armatosura të synojë zhvillimin e kapaciteteve të duhura për realizimin me sukses të operacioneve luftarake dhe joluftarake, operacioneve për menaxhimin e krizave dhe përballimin e emergjencave civile, si dhe krijimin e elementëve të forcës rezervë;
- Modernizimi i FA-së me armatim-municion, pajisje dhe sisteme, të ketë si përparësi strukturat dhe elementët e përcaktuar të forcave dhe komandave, të cilat do të angazhohen në operacionet e Aleancës, programet e modernizimit në kuadër të përmbushjes së Objektivave të Kapaciteteve 2017, si dhe për krijimin e kapaciteteve për përballimin e emergjencave civile;
- Prioritet në Forcën Tokësore të jetë modernizimi i sistemeve dhe pajisjeve, kompletimi dhe përgatitja për certifikimin e b2k dhe elementëve mbështetës të Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (GBKL), sistemet e mbështetjes me zjarr, sistemet e zbulimit taktik, mbajtja dhe konsolidimi i aftësive operacionale të strukturave të deklaruara në Forcën Reaguese të NATO-s, në Task-Forcën e Përbashkët të Gatishmërisë Shumë të Lartë dhe konsolidimi i kapaciteteve operacionale të Batalionit të Forcave Speciale për kryerjen e operacioneve jashtë vendit deri në nivel kompanie (Special Operational Land Task Group - SOLTG);
- Në këtë kontekst, Forca Tokësore të zhvillohet në koncept dhe praktikë, si forcë plotësisht e ndërveprueshme në vetvete dhe me strukturat e NATO-s, me aftësi reale operacionale për lëvizshmëri, fleksibilitet dhe reagueshmëri të lartë dhe me aftësi të plota të komandim-kontrollit (C2). Kompletimi 100 % organik i strukturave të planifikuara për operacionet luftarake dhe joluftarake, elementëve mbështetës të Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë të mbetet prioritet;
- Modernizimi i Forcës Detare të synojë rritjen e operacionalitetit të anijeve të klasit "ILIRIA", duke realizuar kompletimin e tyre me të gjithë elementët e kërkuar të sistemit digjital të identifikimit të anijeve luftarake (AIS-W) dhe armatim 20 mm, me

qëllim përmbushjen me sukses të detyrave dhe të kontributit të saj në “Standing NATO Maritime Group 2”, në kuadër të aktiviteteve detare të NATO-s për adresimin e fluksit të refugjatëve në detin Egje, gjatë vitit 2018;

- Prioritet të veçantë t’i jepet përmirësimit të kapaciteteve të monitorimit dhe vëzhgimit të hapësirës detare me blerjen e softit të ri dhe të kamerave infrakuqe, duke synuar rritjen cilësore të këtij shërbimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Zhvillimi i kapaciteteve të antindotjes të jetë objekt i punës në përgatitjen e kërkesave operacionale për këto kapacitete;
- Forca Ajrore të sigurojë ngritjen e kapaciteteve operacionale për vëzhgimin, monitorimin në mënyrë të pandërprerë të hapësirës ajrore të RSH-së, nëpërmjet realizimit në një kohë të shkurtër të fazës së parë të projektit të modernizimit të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore, duke synuar kontrollin e sigurt të mjeteve ajrore kombëtare ushtarake dhe civile, rritjen e sigurisë së fluturimit, lidhjen me Sistemin e Integruar të Mbrojtjes Ajrore dhe Raketore të NATO-s, si dhe me sistemin e menaxhimit të trafikut ajror civil në vendin tonë;
- Objekti i punës gjatë vitit 2018 të jenë sistemet vetëmbrojtëse të helikopterëve, studimi, hartimi i Kërkesave Operacionale për krijimin e bazave fillestare të mbrojtjes ajrore me sisteme të Mbrojtjes Ajrore të Bazuar në Tokë për mbështetjen e Grup-Batalionit të Këmbësisë së Lehtë, si dhe për interesa kombëtare;
- Trajnimi i personelit pilot, teknik, specialist, kontrollor të trafikut ajror të synojë rritjen profesionale, rritjen e kapaciteteve trajnuese dhe fluturuese në përmbushje të misionit dhe detyrimeve ndaj Aleancës;
- Zhvillimi dhe modernizimi i Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit të ketë prioritet fillimin e punës për krijimin e Njësisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike në bashkëpunim me partnerët tanë strategjikë, zgjerimin e mëtejshëm të rrjeteve kompjuterike (të klasifikuar dhe paklasifikuar) në përshtatje me ndryshimet strukturore të FA-së dhe kërkesat e Sigurisë së Informacionit dhe Mbrojtjes Kibernetike, përmirësimin e kapaciteteve operacionale të implementura në strukturat e FA-së, dhe sigurimin e komandim-kontrollit (C2) me strukturat pjesëmarrëse në misionet jashtë vendit, si dhe me Komandat bashkëvepruese të NATO-s.

#### **4. Gatishmëria dhe operacionaliteti**

- Fokusi kryesor në këtë drejtim të jetë përsosja e sistemit të gatishmërisë luftarake për përmbushjen e misionit kushtetues, garantimin e sovranitetit dhe integritetit të vendit deri në aktivizimin e burimeve të tjera kombëtare dhe/apo aktivizimin e Nenit 5 të Aleancës, në përputhje me Nivelin e Ambicies (NiA), si dhe arritjen e niveleve të kërkuara operacionale të strukturave ushtarake në të katër treguesit, në përputhje me Planin e Kapaciteteve Operacionale;
- FA të jenë të gatshme për të përmbushur misionin kushtetues dhe detyrimet ligjore, për përballimin e emergjencave civile, rritjen e angazhimit në ndihmë të komunitetit dhe në mbështetje të Aleancës, duke pasur si prioritet gatishmërinë e mjeteve, tokësore, ajrore dhe detare;

- Të kompletohen njësitë dhe repartet me personel, armatim dhe pajisje, në përputhje me nivelet operacionale të formacioneve ushtarake të FARSH-it, për periudhën 2017-2021;
- Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, komandantët e Forcave, të kenë prioritet të punës së tyre përgatitjen, ndjekjen dhe zbatimin e planeve të veprimit për arritjen e normave sipas rregullores së re të gatishmërisë, në harmoni me normat e gatishmërisë së NATO-s, si dhe të zbatojnë në kohë programet për pajisjen, stërvitjen dhe modernizimin e tyre;
- Të vijojë kontributi i Forcave të Armatosura në mbështetje të tri detyrave kryesore të Aleancës. Mbrojtja kolektive të përmbushë angazhimet në Strukturën e Komandimit dhe Forcës së NATO-s, Planin e Masave për Gatishmërinë, në Forcën e Përparuar të NATO-s, si dhe pjesëmarrjen në Mekanizimin Rajonal për Jugun. Në kuadër të menaxhimit të krizave të vijnë angazhimet kombëtare për kontribute në operacionet e drejtuara nga NATO, BE dhe OKB, (RSM-Afganistan, KFOR- Kosovë, ALTHEA-BiH, EUTM-Mali dhe operacioni në detin Egje), duke synuar rritjen e kontributeve në RSM me kapacitete të Batalionit të Forcave Speciale. Të vijojë angazhimi për bashkëpunimin për siguri, duke marrë pjesë në iniciativa të ndryshme të Projektimit të Stabilitetit përtej kufijve të NATO-s;
- Angazhimi i Forcave të Armatosura në mbështetje dhe ndihmë të komunitetit, të jetë një nga prioritetet kryesore të punës në përmbushje të misionit dhe detyrimeve ligjore ndaj autoriteteve të pushtetit qendror dhe atij lokal. Për këtë, të përgatiten plane dhe të mbahen nivele të larta gatishmërie për kapacitete të emergjencave civile dhe ato të kërkim-shpëtimit. Të konsolidohet roli i Qendrës së Emergjencave Civile, Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit, si strukturë kryesore për menaxhimin e operacioneve të kërkimi-shpëtimit dhe të emergjencave civile.

## 5. Arsimimi, stërvitja dhe ndërveprimi

- Arsimimi, trajnimi dhe stërvitja, të synojnë plotësimin e nevojave të FA-së me burime njerëzore të afta dhe profesionale, në të gjitha nivelet dhe të kryhet në qendrat arsimore të saj dhe sipas rastit dhe specifikave edhe në vendet aleate e partnere, bazuar në planet e bashkëpunimit;
- Arsimimi t'i paraprijë kërkesave dhe prirjeve të transformimeve të FA-së në përshtatje të plotë me nevojat që kanë për arsimim dhe kualifikim në të gjitha nivelet me fokus përmirësimin e cilësisë së trajnimeve, duke u bazuar në konceptin e ri të arsimimit dhe trajnimit individual dhe kolektiv në përputhje me misionin dhe detyrat kryesore të FA-së. Arsimimi dhe trajnimi funksional të kryhet në funksion të plotësimin të kërkesave të forcave për aftësimin e personelit ushtarak e civil për kryerjen e detyrave funksionale;
- Doktrinat të përditësohen në përputhje me dokumentet strategjike kombëtare dhe doktrinat e Aleancës, në funksion të përmbushjes së interesave kombëtare. Prioritet të jenë çështjet doktrinare për zhvillimin e konceptit të përdorimit dhe pjesëmarrjes në operacione në kushtet e reja të mjedisit të sigurisë, në kushtet e kërcënimeve dhe rreziqeve hibride, pjesëmarrjes në operacioneve për mbrojtjen kolektive, emergjencave civile dhe bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe lokale.

- Stërvitja të synojë standardizimin dhe konsolidimin e sistemit të stërvitjes individuale dhe kolektive në funksion të përmbushjes të misionit kushtetues, Nivelit të Ambicies së FA-së dhe të angazhimeve në kuadër të NATO-s, BE-së dhe OKB-së. Synimi kryesor i stërvitjes të jetë kompaktësimi dhe aftësimi i shtabeve, trupës, reparteve, njësive ushtarake për të gjithë spektrin e operacioneve, brenda dhe jashtë vendit;
- Arritja e gatishmërisë operacionale të Grup-Batalionit të Këmbësores së Lehtë (2019) të jetë prioriteti kryesor i stërvitjes gjatë vitit 2018. Përgatitja e elementëve të Mbështetjes së Luftimit dhe Mbështetjes me Shërbime të Luftimit të grup-batalionit të realizohet nëpërmjet stërvitjeve speciale deri në nivel grupi. Stërvitja dhe trajnimi i strukturave që marrin pjesë në misionet jashtë vendit të kryhet në përputhje me natyrën e misioneve përkatëse;
- Të rriten dhe të shfrytëzohen mundësitë e pjesëmarrjes së njësive të deklaruara në NATO në stërvitjet që zhvillohen në kuadër të mbrojtjes kolektive të Aleancës dhe stërvitjet dypalëshe me partnerët strategjikë, si dhe të sinkronizohen stërvitjet kombëtare me NATO-n, duke synuar rritjen e pjesëmarrjes së aleatëve dhe partnerëve në stërvitjet kombëtare të FA-së;
- Të zgjerohet pjesëmarrja e Forcave të Armatosura në stërvitjet rajonale;
- Stërvitjet ndërinstitucionale të planizohen dhe të zhvillohen me fokus trajnimin e personelit, koordinimin midis strukturave përgjegjëse kombëtare, rritjen e bashkëpunimit reciprok për të garantuar mbështetjen e popullsisë në përballimin e emergjencave civile, luftën kundër terrorizmit dhe atë kibernetike;
- Ndërveprimi në doktrina, struktura, stërvitje, pajisje e sisteme, procedura dhe personel të ketë si prioritet njohjen, përditësimin, zbatimin e doktrinave nga të gjitha strukturat e FA-së, intensifikimin e procesit të standardizimit, nëpërmjet përzgjedhjes, ratifikimit dhe zbatimit të STANAG/AP-ve që mbështetesin Objektivat e Kapaciteteve dhe prioritetet e FA-së;
- Standardizimi të mbështesë planet e modernizimit dhe të jetë në përputhje me mundësitë financiare, prioritetet, objektivat e kapaciteteve, si dhe të mbështesë rritjen e ndërveprimit për pjesëmarrjen e njësive të FARSH-it në angazhimet e Aleancës.

## 6. Burimet e Mbrojtjes

### Burimet njerëzore

- Menaxhimi i personelit të synojë rritjen e profesionalizmit dhe të pajisë Forcat e Armatosura me personel ushtarak dhe civil të aftë, bashkëkohor, vizionar dhe të gatshëm të marrin përgjegjësi drejtimi dhe komandimi, në përmbushje të misionit dhe përballimin e sfidave;
- Rekrutimi i ushtarakëve dhe përparimi në karrierë të realizohet me kriteret fikse dhe procedura transparente konkurimi, duke garantuar shanse të barabarta sipas kontributit, meritës dhe potencialit në interes të Forcave të Armatosura;
- Nëpërmjet politikave të reja për menaxhimin e burimeve njerëzore, transparencës për të gjitha kurset e kualifikimit dhe edukimit, të mundësohet krijimi i shanseve të barabarta për ushtarakët që shërbejnë dhe ata që do të rekrutohen në Forcat e Armatosura;

- Përzgjedhja e ushtarakëve për dislokim në misione të realizohet me procedura transparente dhe në përputhje me kërkesat specifike të tyre;
- Shërbimi vullnetar ushtarak apo civil të zhvillohet si një projekt shoqëror, të shëbejë si një instrument formimi profesional për të rinjtë, si dhe të përbëjë një eksperiencë, ku formësohet vetëdija kombëtare;
- Gjatë vitit 2018, me asistencën e partnerëve tanë ndërkombëtarë, të jetësohet programi në kuadër të misionit “Rini-Talent-Mundësi-Dinjitet”, i cili do të mundësojë sigurimin e një formimi etik dhe ushtarak, në formën e një shërbimi të kontraktualizuar në adresë të të rinjve pa orientim të qartë arsimor apo profesional, me synim formim e ndjenjës kombëtare, ndjenjës së përkatësisë evropiane, formim mbi parimet eurointegruese dhe objektivat e Aleancës së Atlantikut të Veriut, si dhe respektin ndaj simboleve dhe vlerave të tyre universale. Forcat e Armatosura do të japin ndihmesë të rinjve, në orientimin profesional dhe në karrierë, qoftë brenda Forcave të Armatosura, qoftë në jetën civile, publike apo private pas shërbimit;
- Të ruhet përfaqësimi me 15% i femrave në rekrutim e promovim dhe perspektiva gjinore të jetë pjesë e politikave dhe planeve të Ministrisë së Mbrojtjes;
- Gjatë vitit 2018, të vijojë hedhja në sistem e të dhënave të plota për personelin ushtarak në rezervë/lirim dhe digjitalizimi i dokumenteve arkivore;
- Rishikimi dhe përmirësimi i politikave sociale, si përkujdesja sociale, përkujdesja shëndetësore, arsimimi, paga, strehimi dhe ofrimi i shanseve të barabarta, duhet të jetë prioritet i punës i strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, me qëllim motivimin dhe mbështetjen e personelit përgjatë gjithë ciklit jetësor të tyre;
- Kujdes i veçantë të tregohet për familjet e ushtarakëve të dislokuar në misione jashtë vendit.

#### Burimet financiare

- Planifikimi, programimi dhe kërkesat buxhetore të mbështeten në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, Strategjinë Ushtarake, Planin Afatgjatë të Zhvillimit 2016-2025, planin e kapaciteteve operationale, kërkesat e paketës së objektivave të kapaciteteve dhe kërkesat e paraqitura nga strukturat e Forcave të Armatosura, duke siguruar mbështetjen e balancuar midis zërave buxhetorë, me synim rritjen e nivelit të shpenzimeve kapitale për modernizim e infrastrukturë;
- Të mbështeten objektivat e vendosura gjatë fazës së planifikimit dhe kërkesat operationale që u duhen strukturave për të përmbushur misionin e tyre kushtetues, nëpërmjet kryerjes së një analize të hollësishme të kërkesave dhe përcaktimit të prioritetëve kryesore për zhvillimin dhe transformimin e vazhdueshëm të FA-së;
- Të gjitha strukturat të planifikojnë aktivitetet sipas buxhetit, në përputhje me objektivat e dokumenteve strategjike dhe të ndjekin e të raportojnë me rigozitet përmbushjen e tyre. Prioritet të jetë planifikimi, programimi dhe buxhetimi i planeve për përmbushjen e Objektivave të Kapaciteteve, angazhimeve operationale në misionet jashtë vendit dhe atyre në mbështetje dhe ndihmë të komunitetit.

## 7. Mbështetja

- Të vijojë zbatimi i Programit të Automatizuar Logjistik në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura, evidentimi dhe eliminimi i materialeve të tepërta në përdorim të FA-së, sipas kërkesave të gatishmërisë gjatë gjithë ciklit jetësor nëpërmjet shitjeve dhe transferimit në njësi të tjera të sektorit publik në mbështetje dhe ndihmë të komunitetit;
- Të vazhdojë puna për mbikëqyrjen, pastrimin, rehabilitimin, certifikimin e të gjitha zonave të ndotura me municione luftarake dhe mbetje eksplozive në pjesë të ndryshme të vendit, në përputhje me të gjitha standardet e sigurisë dhe kthimin e tyre për përdorim civil pushtetit vendor, duke synuar një Shqipëri të pastër brenda vitit 2018, si dhe të vijojë mbështetja e projektit të gazësjellësit TAP (Trans Adriatic Pipeline) për pastrimin nga municionet e rrezikshme;
- Menaxhimi dhe trajtimi i pronave jashtë Planit të Përhapjes dhe Vendosjes të FA-së të realizohet bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore nëpërmjet privatizimit, qiradhënies, transferimit, regjistrimit, si dhe aplikimit për certifikatë të çdo prone në administrim të strukturave të saj;
- Të punohet për rijetësimin e ndërmarrjeve ushtarake dhe linjave të prodhimit, nëpërmjet përthithjes së investimeve nga kompanitë e vendeve të NATO-s;
- Mbështetja logjistike të bazohet në përdorimin e resurseve ekzistuese apo nëpërmjet kontraktimit të mallrave dhe shërbimeve dhe të sigurojë kapacitetet e nevojshme për mbështetjen me transport, mirëmbajtje, shërbime fushore, shkëmbim të informacionit logjistik, menaxhimin e materialeve të strukturave të FA-së në veprimtarinë e tyre të përditshme, pjesëmarrjen në operacione brenda dhe jashtë vendit;
- Mbështetja e strukturave të deklaruara si pjesë e Forcave të Gatishmërisë së Lartë dhe atyre pjesëmarëse në misionet jashtë vendit të jetë prioritet;
- Mbështetja shëndetësore të fokusohet në drejtim të rritjes të përkujdesjes mjekësore për personelin ushtarak dhe civil të FA-së, informatizimit të të dhënave mjekësore, vlerësimit dhe certifikimit të gjendjes shëndetësore të efektivave, mbështetjes shëndetësore të reparteve prioritare dhe aftësimin të personelit të tyre mjekësor;
- Mbështetja sociale të synojë përmirësimin e trajtimit financiar të ushtarakëve dhe kushteve për jetesë, punë dhe stërvitje të personelit të FA-së;
- Angazhimi në mbështetje dhe ndihmë të komunitetit të jetë një nga prioritetet e punës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe FA-së. Puna të fokusohet në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës dhe në veçanti në ndërtimin e urave tip “Bailey”, në studimet e aksesve kryesore të rrugëve, vijës bregdetare, digave dhe lumenjve për gjendjen dhe sigurinë e tyre. Të hartohen plane rezervë dhe të rriten e të modernizohen kapacitetet për përballimin e emergjencave civile;
- Të vijojnë investimet në fushën e infrastrukturës në funksion të mbështetjes së projekteve të modernizimit, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të kushteteve të jetesës, punës dhe stërvitjes së personelit.

## 8. Legjislacioni

- Të vijojë procesi i zbatimit të akteve ligjore në fuqi dhe nxjerrja e të gjitha akteve të nevojshme nënligjore në zbatim të tyre;



- Të mbështeten iniciativat dhe propozimet e strukturave të MM-së dhe SHPPFA me bazën e nevojshme ligjore, me qëllim plotësimin e kuadrit ligjor në fuqi, me fokus statusin e ushtarakut, trajtimin e punonjësve të Angjesisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, funksionimin e Institucionit të Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, për krijimin dhe funksionimin e elementëve të Forcës Rezervë, hartimin e projektakteve për miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare;
- Të mbështetet dhe të ndiqet me përparësi hartimi i projektakteve, në lidhje me vijimin e procesit të trajtimit dhe reduktimit të pronave jashtë Planit të Vendosies dhe Përhapjes të FARSH-it.

#### **9. Bashkëpunimi**

- Bashkëpunimi ushtarak të jetë në harmoni të plotë me objektivat e politikës së jashtme, në interes të zhvillimit të kapaciteteve të FA-së dhe të synojë rezultate në modernizim, edukim, trajnim dhe stërvitjet e përbashkëta, për të rritur besimin, mirëkuptimin reciprok dhe intensifikimin e dialogut mbi sigurinë;
- Angazhimi në NATO dhe bashkëpunimi me vendet partnere të ketë si prioritet rritjen e numrit të aktiviteteve, të cilat mbështesin zhvillimin dhe zbatimin e Paketës së re të Objektivave të Kapaciteteve, ngritjen, funksionimin dhe akreditimin e Qendrës së Ekselencës për adresimin e fenomenit të Luftëtarëve të Huaj, si dhe vijimin e punës për ngritjen e Njesisë Ushtarake të Mbrojtjes Kibernetike;
- Të vijojë angazhimi aktiv, përfaqësimi cilësor në përmbushjen e detyrimeve në kuadër të NATO-s, BE-së, OSBE-së, OKB-së apo nismave rajonale për rritjen e masave të mirëbesimit, paqes, sigurisë në rajon dhe më gjerë. Fokus të jetë angazhimi në NATO, bashkëpunimi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës si partneri kryesor strategjik, vendet Aleate, Kosovën, si dhe me vendet e rajonit;
- Të intensifikohet bashkëpunimi ndërinstitucional me organet e pushtetit qendror dhe atë lokal, organizatat joqeveritare dhe median në funksion të realizimit me sukses të angazhimeve në mbështetje dhe ndihmë të komunitetit;
- Të përmbushen cilësisht detyrimet në kuadër të “Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastrioti Skënderbeut”, në të cilin Forcat e Armatosura do të jenë një nga pikat kryesore të referimit;
- Rëndësi e veçantë t’i kushtohet Komunikimit Strategjik, për përcjelljen në mënyrë korrekte të mesazheve, rritjen e vlerave të imazhit të FA-së, transparencës dhe promovimit të aktiviteteve në interes të informimit publik.

#### **IV. PËRFUNDIME**

Në përmbushje të detyrimeve për zbatimin e kësaj direktive, kërkoj nga të gjitha strukturat e MM/FARSH të hartojnë plane e programe konkrete veprimi, si dhe të marrin të gjitha masat për realizimin në kohë e me cilësi të tyre.

**MINISTRI**

**Olta Xhaçka**